REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:004227

Datë: 24.12.2020

Numri i dokumentit: 01371123

PKR.nr.2673 /2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM në përbërje nga gjyqtarja e vetme gjykuese Naime Krasniqi- Jashanica ,me zyrtaren e lartë ligjore Dafina Gashi duke vendosur në çështjen penale të akuzuarit G. M.-it , për shkak të veprës penale Lëndim i lehte trupor nga neni 188 par 1 nen 1.4 te KPRK se, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.I.nr.2109/17 te dt 11.05.2017 pas shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 07.12.2020, në të cilin ishin të pranishëm: Prokurori i Shtetit Elza Bajrami, i dëmtuari R. C. dhe i akuzuari G. M. i përfaqësuar nga mbrojtësi i tij sipas autorizimit av N. S., e me datën 09.12.2020 mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari, G. M. i biri i H. dhe Z. e vajzërisë G. i lindur me datë ... në Prishtinë e me vendbanim ne Rr:" I. K." objekt banimi Kati i ..-të nr .. ku edhe tani banon me numër persona .... ka përfunduar fakultetin juridik i pa nunë i gjendjes të mesme materiale shqiptar –shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 31.03.2017, rreth orës 20:00, në rr. " Rrustem Statovci " në Prishtinë, saktësisht tek kafiteri "A.." , pas një mosmarrëveshje të atëçastshme në mes të pandehurit dhe të dëmtuarve B.. K.. dhe R.. C.., me dashje që ti shkaktoj lëndime trupore, fillimisht i kishte ftuar ne kafiteri dhe pas fjalosjes i njëjti me një shufër gome i kishte goditur ne kokë dhe pjese tjera te trupit dhe si pasojë e këtyre veprimeve ju ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasojë të përkohshme për shëndetin,

- me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK, si dhe neneve 365 e 495, të KPP të Republikës së Kosovës, të pandehurit i shqipton:

2020:004228

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **250 (dyqindepesëdhjetë euro) €,** të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditëve**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për **20 (njëzet) € të gjobës**.

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë ekspertizën mjeko-ligjore në shumë prej **20 €,** ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumën prej **20 (njëzet) €,** dhe pesëdhjetë (**50.00) €,** për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit**,** në afat **prej 15 ditësh**, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

Të dëmtuarit B. K. me vendbanim ne rr:" V.. " pn Prishtinë dhe R. C. me vendbanim ne RR:" Sh. S." nr .. Prishtinë . për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP.I.nr.2109/2017 te dt 11.05.2017 e ka akuzuar G. M. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-së në dem të tani te dëmtuarve B. K. dhe R. C.

Kjo Gjykatë në përbërje nga gjyqtari i vetëm gjykues lidhur më këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt 23.10.2019 gjatë së cilës seancë u dëgjuan Prokurori i Shtetit dhe i Akuzuari. Pas leximit të aktit akuzues nga Prokurori i Shtetit, i akuzuari , është deklaruar i Pa fajshëm. Gjykata mbrenda afatit ligjor ka caktuar shqyrtimin e dytë dhe mbrenda afatit ligjor i akuzuari nuk ka paraqitu Kërkesë për hedhjen e Aktakuzës dhe kundërshtimin e provave. Tutje në këtë çështje penale nuk është proceduar për shkak se është bërë bartja e kësaj lende nga një gjyqtar në tjetrin.

Kjo Gjykatë në përbërje nga Gjyqtarja e çështjes pasi e ka pranuar ketë lëndë në punë me datën 07.10.2020 ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datën 19.11.2020 dhe ne mungesë te të akuzuarit shqyrtimi gjyqësor eshët shtyre për datën 07.12.2020 .Ne shqyrtimin gjyqësor te datës 07.12.2020 kanë prezantuar Prokurori i shtetit E. B. i dëmtuari R. C., i akuzuari G. M. dhe mbrojtësi i tij av N. S. Tutje pas leximit të aktakuzës nga Prokuroria e Shtetit , i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, si dhe ka shtuar se i vie keq qe gjendet në gjykatë nga se është hera e parë qe bie ndesh me ligin Po ashtu ,ka shprehur ndjenjën e pendesës dhe kërkim faljes dhe ka shprehur gatishmërinë e qe ti kompensoj te dëmtuarit.

Mbrojtësi i tij av N. S. ka mbështetur deklarimin e te mbrojturit te tij për pranimin e fajësisë sikur qe ka njoftuar gjykatën se i mbrojturi i tij ishte konsultuar mjaftueshëm me mbrojtjen për favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Sa i përket pranimit të fajësisë nga i akuzuari, Prokurori i Shtetit, ka deklaruar, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë konform dispozitave të KPPK, me vullnetin e tij, i akuzuari i ka kuptuar pasojat dhe në përputhshmëri të plotë me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimi i fajësisë.

Pas deklarimit të te pandehurit se ndihet fajtorë për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga Prokuroria, gjyqtarja me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi është bindur se ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht dhe është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza,. andaj nuk administroj prova kaloj në fjalën përfundimtare të palëve në procedure .

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare deklaron se: qëndron pranë aktakuzës e cila është e mbështetur në fakte dhe prova bindëse me të cilat vërteton dyshimin mirë të bazuar se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv ët kësaj aktakuze dhe atë me datë dhe kohë si më lartë. Aktakuza është përpiluar në bazë të ligjit siç u pranua edhe nga vet i akuzuari, gjykatës me rastin e marrjes së sanksionit penal i propozojë ti ketë parasysh rrethanë posaçërisht lehtësuese të mirët pranimi i fajësisë dhe krejt në fund i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit.

I Dëmtuari R. C. në fjalën përfundimtare deklaron se si pasoj e goditjes me një shkop të gomës ka pësuar lëndime trupore- thyrje të dorës se majtë duke pretenduar se përveç tani të akuzuarit atë e kishin goditur disa pasona tjerë qe ishin të shoqëruar me tani të akuzuarin por pasi është njoftuar me te gjitha shkresa të lendes sikur qe me kallëzimin penal me nr të rastit 2017 –AB-... te datës 06.04.2017 kundër të pandehurit G. M. ne drejtim te veprës penale Lëndim i lehte trupor nga neni 188 par 1 .nen par.1.4 të KPRK se dhe se vërtet ka pësuar lëndim te lehtë trupore vërteton mendimi i ekspertit mëko-ligjor Dr V. H. dhe dr F. D. i lëshuar me datën 27.04.2017 i cili mbi bazën e diagnozës ka konstatuar se i dëmtuari R. C. ka pësuar plagë qarëse –shqyese të indeve të buta të kokës të fytyrës të krahut të doras së majtë dhe te ne gjurit të këmbës së majtë dhe si te tilla një nga një dhe se bashku bëjnë pjese në Dëmtime të lehta trupore dhe me dëmtim te përkohshëm të shëndetit. I dëmtuari nuk e ka precizuar kërkesën pasurore -juridike andaj është udhëzuar ne kontest e rregullt juridiko-civil.

Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit G. M.-it Av.N. S. deklaron se: me qen se në këtë shqyrtim gjyqësor i mbrojturi im ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohej andaj mbrojtja i propozon gjykatës i qe me rastin e vendosjes lidhur me vendimin për sanksionin penal te paraparë ligjor ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese siç janë : se i mbrojturi im G. M. është mirë i pranuar në rrethin e tij familjar dhe social, se me te dëmtuarin R. G. eshët fqinje se me të dëmtuarin B. K. janë pajtuar se koha e kryerjes të kësaj vepre penale nuk kane pasuar asnjë mosmarrëveshje se i mbrojturi im e pranoj bindshëm fajësinë me premtimin se nuk do të bie ndesh me ligjin.

I akuzuari G. M.l në fjalën e tij përfundimtare deklaron se: Nëse flasim për kohën e kryerjes së veprës penale unë në atë kohë isha i shqetësuar nga se vajza ime ishte rrahur nga vajzat e B. dhe R. tri dite me pare atëherë unë thjeshtë desha të bisedoja me tani të dëmtuarit si prindër për rastin ne fjale dhe pasi jemi takuar ne lokalin :"Arena " për një moment ka eskaluar situata dhe jemi rrahur sikur qe edhe sot e asaj dite tani te dëmtuarit B. K. deh këtu i pranishem R. C. i kërkoj falje për rastin qe ka ndolle se ishte kjo rrethanë qe me solli në shkelje të ligjit duke e lutur gjykatën t'ia shqiptoi një dënim më të butë.

Vlerësimi lidhur më dënimin e shqiptuar Gjykata nga shqyrtimi i të gjitha shkresave të lëndës, gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtorë të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

2020:004228

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si në vijim: pranimin e fajit; sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit fillestar dhe sjelljen e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale, duke pasur parasysh se sipas të dhënave të kësaj gjykate ndaj këtij të akuzuari nuk ka të ngritur ndonjë aktakuzë tjetër dhe nuk është i dënuar më parë; ndërsa gjykata si rrethanë rënduese morri intensitetin e dëmtimit te vlerës te mbrojtur me ligj e që ne rastin konkret ishte jeta dhe trupi i dy të dëmtuarve prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të te akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK-së ,

Përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPK, kurse vendimi mbi taksën për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të neneve: 3; 6 dhe 39, par .3.2 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 188/1 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DEVIZIONI PENAL
PKR.nr.2673/2017 te, datë 09.12.2020.

Zyrtarja e larte ligjore ,
Dafina Gashi

- Gjyqtarja e vetme gjykuese ,
Naime Krasniqi –Jashanica

UDHËZIMI JURIDIK:
Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

2020:004228